

Ne fokus/ Tifozet e Kamzes hapin me force stadiumin

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 14 Shtator 2013 22:13



Nje histori e rralle shqiptare ka ndodhur te shtunen ne Kamze. Tifozet dhe drejtuesit e skuadres kane hapur me force dyert e stadiumit per te luajtur futboll aty. Kryetari i Bashkise Xhelal Mziu, per inate personale dhe pa asnje shkak dy jave me pare i vuri drynin stadiumit duke mos i lene lojtaret te luanin ndaj Luftetarit. Te shtunen, tifoz dhe dretues te Kamzes jane perleshur me forcat e policise dhe ne fund kane dale fitues duke arritur te futen brenda ne stadium pasi kane shkyer drunin dhe deren kryesore. Policia nuk e ka marre persiper zhvillimin e ndeshjes Kamza-Ada dhe drejtuesit e skuadres se Kamzes kane marre polici private. Takimi ka nisur me vonese por u luajt dhe ne fund ndeshja u mbyll barazim 2-2.